

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUQISHËM  
 DËLUKA JË PRAVDOSNAËNA  
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
 FERIZAJ I UROSEVAC

Më  
 Dana 09 - 04 - 2018



**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i Përgjithshëm-  
 Divizioni Penal-** në përbërje prej gjyqtarit individual Elmaz Zenuni, me Zyr.ligjor Gazmend Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajt, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 2036-4/2017 të datës 17.11.2017, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me Kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 2036-4/17 të datës 17.11.2017, për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor, më datën 14.02.2018 mori:

**AKTGJYKIM**

**PRANOHET** Kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr. 2036-4/17 të datës 17.11.2017, gjykata jep:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

I pandehuri, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e Ferizajt , e lindur më [REDACTED] nga babai [REDACTED] i gjendjes së varfër ekonomike, shtetas i Republikës së Kosovës.

## ËSHTË FAJTORE

Sepse më datën 30.08.2017 rreth ores 13:30 në pyllin publik në vendin e quajtur "Livadhet e gjata" në Rajonin e Ekonomisë Pyjore, Nerodime –jezerc është takuar duke prerë 40 copë dru të ahut të njom me diameter 10-15 cm, me vëllim të përgjithshëm 3.60 metra kub ,të cilat i ka bartur me kali në vlerën e demit të shkaktuar prej 550.08 euro,

**Me të cilën ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPRK-së dhe neneve 365 e 495 të KPPRK-së të pandehurin gjykata e:

## GJYKON

**DENIM ME GJOBË** në lartësi prej 200 euro(me shkronja dyqind euro) i cili denim ekzekutohet në afat prej 15 dite nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burg.

Obligohet i pandehuri që në emër të kërkesës pasuroro-juridike të dëmtuarës DBP-zyra në Ferizaj të i kopmensoj dëmin e shkaktuar të dispozitivit të këtij aktgjykimi në shmën prej 550.08 Euro (me shkronja:pesqind e pesdhejetë euro e tet cent) në afat prej 15 dite nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë nën kërcënim të ekzekutimit me detyrim .

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Ferizaj me akuzën e vetë PP/II nr. 2036-4/17 të datës 17.11.2017, ka akuzuar të akuzuarin [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së, e njëjtu, ka ushtruar Kërkesë për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna e Ferizajt me arsyetim se ka prova të besueshme nga Kallëzimi penal që e vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe Kërkesës për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënjen e Urdhërit Ndëshkimor në kuptim të nenit 493 par.1 të KPPRK-së.

Gjykata, duke vlerësuar Kallëzimin penal të DBPZH-APK-Zyra në Ferizaj 623/2017 të dt.20.09.2017, të cilat gjinden në shkresat e lëndës vërtetoi pa mëdyshje se i pandehuri ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së .

Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe konform nenit 495 të KPPRK-së i shqiptoi dënimin me gjobë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 498 të KPPRK-së , gjykata i shqiptoi të pandehurit dënimin me gjobë, pasi që gjykata vlerësoi shkresat e lëndës dhe konstatoi se ekzistojnë prova të besueshme se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet dhe me aktgjykim me Urdhër ndëshkimor e ka shpallur fajtor dhe e ka denuar me dënim sipas ligjit.

Në bazë të nenit 458-460 të KPPRK-së, i pandehuri në emër të kërkesës pasuroro-juridike për kompensimin e dëmit të dëmtuarës Drejtoria për Bujqësi, pylltari-Zyra në Ferizaj obligohet që të ia kompensoj dëmin e shkaktuar në lartësi prej 550.08 euro.

Konform nenit 450-451 të KPPRK-së, i pandehuri është i obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.


Nga arsyet e lartëshenura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P nr.2905/17, datë 14.02.2018**

**Zyr.ligjor**  
**Gazmend Bytyqi**

**Gjyqtari,**  
**Elmaz Zenuni**



**Këshilla juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Kundërshtim në afat prej 8 dite nga dita e pranimin të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës Themelore në Ferizaj.